

**VENDIM**  
**Nr.1032, datë 16.12.2010**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NDËRTESAVE TË ISH-NDËRMARRJES GJEOLGJIKE, KORÇË, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TE MINISTRIA E FINANCEVE, DHE TË ZYRAVE TË AGJENCISË SË SIGURIMEVE SHOQËRORE, KORÇË, NGA MINISTRIA E FINANCEVE TE MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesave (zyra e ndërmarrjes, godinë 4-katëshe, që i përket objektit 2, laborator, godina 2-katëshe, që i përket objektit 1, dhe këndi i mbledhjeve, që i përket objektit 3) të ish-Ndërmarrjes Gjeologjike, Korçë, e të truallit të lirë (oborr), nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Korçë, sipas planrilevimit dhe formularit të inventarizimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të zyrave të Agjencisë Vendore të Sigurimeve Shoqërore, Korçë, me sipërfaqe 125.3 (njëqind e njëzet e pesë pikë tre) m<sup>2</sup>, të cilat ndodhen në katin e parë të ndërtesës 4-katëshe, në adresën rruga “Sotir Peçi”, Korçë, nga Agjencia Vendore e Sigurimeve Shoqërore, Korçë (sipas vendimit nr.99, datë 21.11.1968 të Komitetit Ekzekutiv të K.P. Rrethit) te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për t’u përdorur nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vendimi nr.635, datë 29.9.2007 i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së Ndërmarrjes Gjeologjike, Korçë, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Ministrinë e Financave”, shfuqizohet.


4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**  
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

| Institucioni i pushtetit qendror                |                                      |                |                                                                         |                                |                                            |                                            |                                       |                                                 |                                                          |                                        |
|-------------------------------------------------|--------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------------|--------------------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| Bashkia: Korçë                                  |                                      |                |                                                                         |                                |                                            |                                            |                                       |                                                 |                                                          |                                        |
| Fusha e përdorimit të pronës: zhvillim ekonomik |                                      |                |                                                                         |                                |                                            |                                            |                                       |                                                 |                                                          |                                        |
| A                                               |                                      |                | B                                                                       |                                |                                            |                                            | C                                     |                                                 |                                                          |                                        |
| Nr. rendor                                      | Zona kadastrale dhe indeksi i hartës | Nr. i pasurisë | Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike                      | Komponentët përbërës të pronës | Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në m <sup>2</sup> ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/enti me përgjegjësi administrative | Institucioni/enti përdorues statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 1                                               | 2                                    | 3              | 4                                                                       | 5                              | 6                                          | 7                                          | 8                                     | 9                                               | 10                                                       | 11                                     |
| 860                                             | 8562<br>Ko-H-11                      | 6/25           | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar<br>Dega rajonale Korçë<br>Rr.Korçë-Bilisht | Magazina                       | Rruga Korçë-Bilisht                        | 210                                        | Zhvillim ekonomik                     | Ministria e Ekonomisë                           | Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë     |                                        |
|                                                 |                                      |                |                                                                         | Hangar                         | Rruga Korçë-Bilisht                        | 188                                        | Zhvillim ekonomik                     | Ministria e Ekonomisë                           | Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë     |                                        |
|                                                 |                                      |                |                                                                         | Ndërtesë                       | Rruga Korçë-Bilisht                        | 210                                        | Zhvillim ekonomik                     | Ministria e Ekonomisë                           | Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë     | Ndërtesë 4 katëshe                     |
|                                                 |                                      |                |                                                                         | Laborator                      | Rruga Korçë-Bilisht                        | 504                                        | Zhvillim ekonomik                     | Ministria e Ekonomisë                           | Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë     |                                        |
|                                                 |                                      |                |                                                                         | Shesh funksional               | Rruga Korçë-Bilisht                        |                                            | Shesh funksional                      | Ministria e Ekonomisë                           | Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë     | (Mbetur në admin. Shtetëror)           |


|                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p align="center"><b>PERGATITJE</b></p> <p>Emri: <u>Robert Paj</u></p> <p>Licensa Nr: T2 0428 Dti: 28.03.2003</p> <p>Data e pergatitjes: 09.06.2010</p> <p align="center"> <br/> Vula/Firma </p> | <p align="center"><b>IDENTIFIKIMI I PASURISE</b></p> <p>ZONA KADASTRALE NR. <u>8562</u></p> <p>NR. I PASURISE <u>NR. 1</u></p> <p>INDEKSI I HARTES <u>KO, H-11</u></p> <p>SHKALLA: 1 : <u>500</u></p> <p>ADRESA E PASURISE: <u>KORSE</u></p> <p>O/I: <u>KORSE</u> PR. IX. ISH. NR. GJEOLLOGJIKE</p> <p>P/G: _____ Sh _____ K _____ AP _____</p> <p align="center"><u>SHITETI</u></p> <p>PRONARI ( emri, mbleshti, firma ) _____</p> |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

**SKEMA ORIENTUESE**  
**SHK. 1:500**



**ISH NDERMARJA GJEOLLOGJIKE**

**SHK. 1:500**



|                                  |          |                       |
|----------------------------------|----------|-----------------------|
| SIPERfaqe objekti NR. ①          | 2 KT     | 312.04 m <sup>2</sup> |
| " " " NR. ②                      | 4 KT     | 110.8 m <sup>2</sup>  |
| " " " NR. ③                      | 1 KT     | 425.4 m <sup>2</sup>  |
| " " " NR. ④                      | VENDROJE | 17.6 m <sup>2</sup>   |
| " " " TRUALLI (SHESH) FUNKSIONAL | ⑤        | 1579.8 m <sup>2</sup> |
| " " " GJITHSEj                   |          | 2445.6 m <sup>2</sup> |

**KUFIZIMET**

VERI - PAS. NR. 6/26 (RRUGE)

LINDJE - PAS. NR. 6/178, 6/139, 6/140

JUG - PAS. NR. 6/22, 6/146

PERENDIM - PAS. NR. 6/24 (RRUGE)